Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-546
Datë: 18.10.2018

Në mbështetje të neneve 15, pika 2, dhe nenit 17, pikat 1.5, 1.6 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, dhe 18, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 05.10.2018, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet aplikacioni për validim, akreditim dhe raporti i vetëvlerësimit për Kolegjin "Pjetër Budi", me kualifikimin TIK (ECDL basic, standard, dhe advance për tri nivele).
2. Këshilli Drejtues rekomandon AKK që të vazhdojë me procesin sipas legjislacionit në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi u dërgohet:
   - Kolegjit "Pjetër Budi"; dhe
   - AKK.

Kryetarja e KD së AKK
Violeta Dema